

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	SPECIALE/ Ervin Demushi ndërton të ardhmen në Alpe, historia e të riut që refuzoi emigrimin për të rikthyer traditën e të parëve - Shqiptarja.com
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/speciale-ervin-demushi-nderton-te-ardhmen-ne-alpe-historia-e-te-riut-qe-refuzoi-emigrimin-per-te-rikthyer-traditen-e-te-pareve
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 09:08:17 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 09:01:41 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a48dc7683eaab9988e183f4bb344322650c56d7d006509f9570559830e12fbfb
TEKSTI	2a32650f97f994e99c5db377c8747c49e68818cf7f2920d358cb9fac7ec5f53a
PAMJA	d1caddc5996ec40070bc6b7a1fb3612d9f90627374d842c595551625952f9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	172b5d16945e76b06b58c250e10190a7e82c31fa154759d42bb5559c546916fe
E MËPARSHMJA	23a55bae4ab72343b493d6186b374155f7d9c7e5ca40cee1341945dd24c2c82d
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/172b5d16945e76b06b58c250e10190a7e82c31fa154759d42bb5559c546916fe>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Vranësira të dendura në të gjithë territorin, në mesditë nisin reshjet

<>

Sociale

Drejt Punës

Speciale

SPECIALE/ Ervin Demushi ndërton të ardhmen në Alpe, historia e të riut që refuzoi emigrimin për të rikthyer traditën e të parëve

Në një kohë ku largimi është kthyer në rregull, Ervini zgjodhi të jetë përjashtimi: "Duajeni vendin dhe mundohuni t'i ofroni diçka!"



Benet Beqiri

20 Shtator, 10:57 | Përditësimi: 20 Shtator, 11:54

f Share Tweet



A A

Mes majave të larta të Alpeve, aty ku gjelbërimi i egër takohet me ujin e kristaltë, stinët kanë një tjetër ritëm. Valbona është zgjuar. Rugët mbushen me vizitorë dhe bujtinat e vjetra hapin dyert për të treguar shpirtin e Tropojës.

Në këtë peizazh ku çdo gur ka një histori, takojmë Ervin Demushin. Ai është nga Gegëhyseni. Prej 25 vitesh, jeta e tij dhe e familjes lidhet një me këtë luginë. Mbi tokën e të parëve, ata kanë ngritur një biznes dhe një ëndërr.

“Ka qenë gjithmonë një ëndërr e jona për të ndërtuar diçka këtu. Që në fëmijëri, unë dhe motrat kemi parë babain që ka qenë gjithmonë optimist për këtë vend, e ka dashur dhe e ka mbrojtur shumë natyrën e kësaj zone si nga djegiet edhe nga prerjet e pyjeve.” shprehet Ervini.



[Sh]
.com

LEXO EDHE:

Në kërkim ndërkombëtar për trafik droge, arrestohet në Morinë 34-vjeçari nga Kosova (EMRI)

Për të, dita nis mes tingujve të natyrës dhe përfundon pranë oxhakut, duke u shërbyer miqve fli e produkte zone.

“Kjo zonë quhet Bjeshkët e Krasniqes. E kemi të trashëguar nga të parët tanë. Dhe kjo pjesë ku ndodhemi quhet Ziçi i Valbonës. Çdo majë e kam shëtitur sepse ne kemi bjeshkë të mrekullueshme. Janë Çeremi, Dobërdoli, Tërkuzi e shumë të tjera të cilat realisht janë të mahnitshme. Unë shpesh herë bëj hiking me turistët dhe gjithmonë ndaloj për të bërë fotografi. Çdo muaj ke mundësi të shohësh diçka të re.” tregon 31 vjeçari.

Por jeta e Ervinit është e ndarë mes dy botëve. Pasi përfundon turnin e tij në HEC-in e Fierzës, ku punon prej gjashtë vitesh, ai nxiton drejt Valbonës.

“Kam mbaruar inxhinieri mekanike. Aktualisht jam punonjës pranë Hec-Fierzë, krahas punës atje kemi 5-6 vite që kemi ngritur këtë biznes familjar me disa bujtina duke u përpjekur që të ringjallim sadopak traditën tonë. Sepse turistët e huaj janë shumë të interesuar për historinë, kulturën, gatimet tradicionale. Ata nuk vijnë për luks por veçanërisht për mikpritjen e banorëve të zonës” tregon [Ervin Demushi](#).

Pikërisht kjo mikpritje bën që vizitorët të mos mjaftohen me një vizitë. Shumë prej tyre kthehen sërish, të dashuruar pas traditës që përcillet brez pas brezi.

“Kemi ardhur nga jugu i Francës. Do të qëndrojmë ca ditë këtu. Më pas do të ikim në Itali për një javë. Është shumë e rëndësishme të qëndroni e të mos konsideroheni emigrant, por të shijoni bukurinë e gjithçka tjetër këtu. Të vazhdoni ruajtjen e traditës si mbarështimi i deleve apo dhive, gatimet tradicionale. Nëse të gjithë ikin, këtu nuk do të mbetet njeri” thotë një turist francez.

Në një kohë ku largimi është kthyer në rregull, Ervini zgjodhi të jetë përjashtimi. Ai nuk i ktheu shpinën vendit të tij. Nga puna në Fierzë te bujtina në **Valbonë**, ai po dëshmon se më e bukura për këto male nuk është ajo që shihet sot. Është ajo që po ndërtohet për të nesërmen.

"Ka zhgënjime të shkaktuara nga burokracitë shtetërore që të bëjnë pesimist, por duke parë anën e zonës sonë që karakterizohet nga dashuria për këtë vend e për këtë ambient, pjesën e zhgënjimeve kemi mundur ta kalojmë. Të rinjve mund t'i them vetëm dy gjëra: duajeni vendin dhe mundohuni që t'i ofroni diçka. Nëse vërtet e dëshiron diçka secili mund të arrijë qëllimin. Ne jemi ende në fazat e para, por shpresojmë të ecim përpara sepse sot janë mundësitë. Për më tepër që turizmi në Shqipëri do të jetë akoma edhe më i kërkuar nga turistët e huaj në të ardhmen." shprehet Ervin Demushi nga Ziçi i Valbonës.

SI.E/H/Shqiptarja.com

TAG: **ervin demushi** **Kukes** **valbone**

Sa e vlerësoni këtë artikull? ★ ★ ★ ★ ★ 4.7 / 5 (3 vlerësime)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH
COM

Sondazhi i ditës:
Haga dënon me 81 vite burg 4 ish-krerët e UÇK-së, si e vlerësoni?

16 Shtator, 14:18

Të drejtë Të gabuar Nuk e di

Lajme të tjera



Pagat e magistratëve/Bojkoti në Gjykatën e Kukësit lë qytetarët pa shërbime: Po tallen me ne, a ka shtet apo s'ka shtet?



Benet Beqiri

15 Shtator, 13:03



Bie numri i nxënësve në disa qytete, shkollat e fshatrave drejt mbylljes! Surprizon Lushnja, regjistron afro 300 nxënës më shumë se vjet

14 Shtator, 16:29



Reshjet e shiut nuk pengojnë qytetarët e Kosovës të kalojnë fundjavën në Shqipëri! Fluks në Morinë (VIDEO)

12 Shtator, 16:57



Drejtori i shërbimeve publike dhe drejtuesi teknik i punimeve u ndaluan pas vdekjes së punonjësit të bashkisë së Tropojës, nis hetimi për dy zyrtarët

10 Shtator, 11:02



Plagosi 29-vjeçarin në këmbë pas konfliktit në Krumë, vetëdorëzohet i dyshuari! Shkon në polici me pistoletën, i gjendet edhe kallashnikov e antiplumb

9 Shtator, 13:39



Punonjësi i bashkisë në Tropojë ndërroi jetë pasi e zuri korrenti, ndalohet drejtori i shërbimeve publike dhe drejtuesi teknik i punimeve (EMRAT)

9 Shtator, 10:54



Has/ Plagosje me armë zjarri në Krumë, në kërkim autori



Po vendosnin ndriçimin e rrugës në Tropojë, 4 punonjësit e Bashkisë i



Zjarr në Borje të Kukësit, era favorizon flakët

6 Shtator, 14:29

8 Shtator, 18:47

kap korenti! Nderron jete
59 vjeçari, tre të tjerë në
spital (EMRAT)



Benet Beqiri

8 Shtator, 13:10



Vespat 'pushtojnë
Prishtinën', nis festivali
ndërkombëtar! 50 prej
tyre nga Shqipëria
(VIDEO)



Benet Beqiri

5 Shtator, 16:15



'Një nga ne'/ Njihuni me
dy kultivuesit e mjedrave
në Kukës: Janë
fitimprurëse, por kanë
shumë sfida! Ja çmimi në
treg



Xhensila Nako

5 Shtator, 15:17



Fundjava sjell fluks në
Morinë, mbi 15 mijë
qytetarë të Kosovës
hyjnë në Shqipëri në 4
orë (VIDEO)



Benet Beqiri

5 Shtator, 10:53

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju

Puno me ne

[Shqiptarja.com]

Kërko



© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohej riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.